



# Worcester Public Schools



Worcester, Massachusetts

Zyra e Inspektimit

Dr. John E. Durkin Administration  
Building

Tel. (508) 799-3115

20 Irving Street

FAKS (508) 799-3119

Worcester, Massachusetts 01609-2493

Qershor 2022

Për Nxënëset/it, Familjet dhe Stafin e Shkollës **Columbus Park School (Shkolla Columbus Park)**,

Gjatë marrjes së kampioneve të fundit të ujit për plumb dhe bakër, disa pajisje në shkollën tonë rezultuan me nivele plumbi mbi kufirin e pranueshëm dhe/ose bakër mbi Nivelin e Veprimit. Kampionet u mbledhën nga të gjitha çezmat dhe pajisjet e përdorura për pije, gatim dhe përdorime mjekësore. Ato u mbledhën në çdo rubinet apo pajisje, si për rastin kur uji ka qëndruar në rubinet gjatë natës, ashtu dhe pasi uji rrjedh për përdorim. Për informacion mbi procedurat e mbledhjes së kampioneve në shkolla, ju lutemi shihni: <https://www.mass.gov/guides/sampling-for-lead-and-copper-at-schools-and-childcare-facilities>

Në përputhje me Manualin e rishikuar 3T të USEPA, programi LCCA i MassDEP rekomandon që shkollat dhe programet e edukimit dhe kujdesit të hershëm të vlerësojnë dhe marrin masa për rregullim të të gjitha çezmave/pajisjeve, të përdorura për konsumim uji, përgatitje ushqimi ose përdorime mjekësore dhe që kanë nivele plumbi mbi kufirin e zbulimit laboratorik, të certifikuar në Massachusetts, prej 1ppb (0,001 miligramë për litër (mg/L)) derisa të arrihet përqendrimi më i ulët i mundshëm i plumbit. Niveli i Veprimit në Massachusetts për bakrin në ujin e pijshëm është 1.3 mg/L (i njohur edhe si pjesë për milion).

Për informacionin nga MassDEP mbi plumbin dhe bakrin në ujin e pijshëm, shihni:

Plumb: <https://www.mass.gov/lead-in-drinking-water>

Bakër: <https://www.mass.gov/doc/fact-sheet-copper-and-your-health>

Për informacion nga Departamenti i Shëndetit Publik të Massachusetts mbi Plumbin dhe Bakrin, shihni:

<https://www.mass.gov/orgs/childhood-lead-poisoning-prevention-program>

## **Rezultatet e kampionimit dhe plani përkatës i veprimit**

Data e kampionimit	Lloji i pajisjes së marrë nën shqyrtim	Vendndodhja e Kampionimit	Rezultati i Plumbit mg/L	Rezultati i Plumbit pas shpëlarjes - prej 30 sekondash mg/L	Rezultati i Bakrit mg/L	Rezultati i bakrit pas shpëlarjes prej 30 sekondash mg/L	Plani i Veprimit
30/03/2022	Lavamani i infermieres/it	Lavaman i banjës së zyrës së infermierit/es	<b>0.044</b>	<b>0.022</b>	N/A	N/A	Vendosni shënimin "Vetëm për Larje Duarsh"
30/03/2022	Të tjera - lavaman	Kuzhina e Edukimit të Veçantë	<b>0.017</b>	<b>0.0061</b>	N/A	N/A	Vendosni shënimin "Vetëm për Larje Duarsh"
30/03/2022	Të tjera – lavaman	Korridori jashtë Dhomës 104	<b>0.0021</b>	0.00029	N/A	N/A	Vendosni shënimin "Vetëm për Larje Duarsh"

Kufiri i zbulimit për plumbin në Massachusetts është 0,001 mg/L dhe Niveli i Veprimit për bakrin është 1,3 mg/L.

Worcester Public Schools (WPS) i marrin këto rezultate shumë seriozisht dhe po ndërmarrin masa për të adresuar problematikat e identifikuara. Ne jemi duke punuar ngushtë dhe në bashkëpunim me MassDEP.

***Përveç hapave specifike të ndërmarrë në shkollën tuaj, WPS po kryen aktivitetet e mëposhtme në të gjithë qarkun:***

1. Vendosja e tabelave të tilla si "*Tabela Vetëm për Larjen e Duarve*" në pajisjet me nivele plumbi dhe/ose bakri mbi kufirin e zbulimit të plumbit dhe/ose Nivelin e veprimit të bakrit, që nuk përdoren për ujë të pijshëm ose për përgatitjen e ushqimit. Shumë nga pajisjet me rezultate mbi nivelet e veprimit ishin lavamanë të përdorur vetëm për larjen e duarve. Departamenti i Shëndetësisë në Massachusetts deklaroi se uji që përmban plumb ose bakër nuk është i dëmshëm nëse përdoret për larjen e duarve.
2. Mundësimi i informacionit për nxënësit/et, familjet, stafin dhe zyrtarët/et lokalë/e.
3. Komunikimi me departamentet e WPS, si të Ushqyerjes, Infermierisë etj., për zbatimin e planeve të veprimit, sipas nevojës.
4. Sigurimi se ka ujë të mjaftueshëm për të pirë dhe për përgatitjen e ushqimit, nëse do të ndalohej përkohësisht përdorimi i pajisjeve për të kryer kampionime të mëtejshme ose për të zbatuar masa korrigjuese. Të gjitha pajisjet ftohëse të ujit, çezma uji dhe aparatet për mbushjen e shisheve të ujit, kanë qenë jashtë përdorimi përpara rikthimit në mësimin drejtpërdrejt, në Mars 2021. Uji në shishe u është vënë në dispozicion të gjithë nxënësve/eve dhe stafit gjatë kësaj kohe.

***Burimet dhe Marrja e Kampioneve të Plumbit dhe Bakrit në Ujin e Pijshëm***

Në Massachusetts, shumica e burimeve të ujit të pijshëm nga rezervuarët dhe ujërat nëntokësore nuk përmbajnë nivele të larta plumbi ose bakri. Plumbi hyn në ujin e pijshëm kryesisht duke u kulluar nga tubat hidraulikë, që përmbajnë plumb, si p.sh. një linjë shërbimi prej plumbi (të gjitha linjat që dihet që përmbajnë plumb janë hequr), që lidh një ndërtesë me rrjetin e ujit në rrugë, ose nga tuba hidraulikë dhe instalimet brenda një ndërtese. Bakri hyn në ujin e pijshëm kryesisht duke u kulluar nga tubat hidraulikë, që përmbajnë bakër.

Rrjedhja e plumbit dhe bakrit ka më shumë gjasa të ndodhë kur uji nxehet ose nuk rrjedh, përgjithësisht gjatë natës ose në raste të tjera kur uji nuk përdoret për disa orë. Prandaj, MassDEP kërkon që kampionimi i pajisjeve të kryhet në mëngjes, pasi uji në ndërtesë nuk është përdorur gjatë natës.


***Një kujtesë nga MassDEP***

Sistemi i ujit në shkollë nuk është ndryshe nga sistemet e ujit që gjenden në ndërtesa të tjera. Sistemet dhe pajisjet më të vjetra hidraulike, veçanërisht, mund të përmbajnë tuba apo saldime, që mund të lejojnë plumbin të hyjë në ujin e rubinetit.

**Ju lutemi, vini re se, për shkak të shqetësimeve në lidhje me Covid-19, pajisje të tilla si ftohësit e ujit, shatërvanët e pijeve dhe aparatet për mbushjen e ujit në shishe kanë qenë jashtë funksionimi dhe të padisponueshme për përdorim gjatë dy viteve të fundit. Uji në shishe i është mundësuar të gjithë stafit dhe nxënësve/eve, që nga rikthimi në proceset e mësimdhënies së drejtpërdrejtë në Mars 2021. Jemi duke punuar me dedikim për të vlerësuar të gjitha burimet e ujit të pijshëm në ndërtesat tona dhe për t'i bërë ato të disponueshme për përdorim gjatë vitit të ardhshëm shkollor 2022 - 2023.**

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë informacion, ju lutemi kontaktoni Departamentin e Faciliteteve të WPS në (508) 799-3151.

Sinqerisht,

Handwritten signature of Rachel H. Monahan in black ink.

***Kryeinspektori i Shkollës***